REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS -
UNIVERSITETSKE BOLNICKE I KLINICKE SLUZBE KOSOVA -
THE HOSPITAL AND UNIVERZITY CLINICAL SERVISE OF KOSOVO
ARKIVI QENDROR - CENTRALNI ARHIV - CENRAL ARCHIVE
Nr. i njesis org / org jed / org.unit
Nr.Prot 7431
Broj. prot
Prot. no.
Nr. i faq. -4-
Br. str.
No. page
Data 21.08.26
Datum
Date
PRISHTINA - PRISTINA

MEDICAL AUSTRIAN
-SCHOOL-

Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Univerzitetski klinički centar Kosova
University Clinical Center of Kosovo

Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë
Austrian Schule
Austrian Schule Medical High School

Në bazë të për Shëndetësi, Statutit (QRK) Nr. 01/2023 të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Statutin (QRK) Nr. 01/2025, Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, palët, duke u mbështetur në vullnetin e tyre të lirë, më 21.08.2026, në Prishtinë, Republika e Kosovës, lidhin këtë:

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI
PËR
KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME TË LARTË TË MJEKËSISË AUSTRIAN SCHULE PRISHTINË NË QENDRËN KLINIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

a) Qendra Klinike Universitare e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: QKUK), me adresë: Lagjja e Spitalit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Mentor Zejnullahu,

dhe

b) Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë Austrian Schule (në tekstin e mëtejmë: SHMLM Austrian Schule), me adresë: Rr. e Gjilanit, km 3, Hajvali, Prishtinë, me Drejtoreshë, Shqiponja Vokshi.

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është realizimi i praktikës profesionale për nxënësit e SHMLM Austrian Schule në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (këtu e tutje QKUK).

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj marrëveshje zbatohen për nxënësit e SHMLM Austrian Schule, programet e të cilës janë të licencuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, dhe të cilët kryejnë praktikën profesionale në QKUK sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Objektivi i marrëveshjes

Objektiv i kësaj marrëveshjeje të bashkëpunimit është përcaktimi i të drejtave dhe detyrave që dalin nga organizimi dhe realizimi i praktikës profesionale për nxënësit e SHMLM Austrian Schule. Praktika profesionale do të realizohet sipas planprogramit të hartuar nga SHMLM Austrian Schule. Ky planprogram do të jetë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në përfundimin e vitit shkollor 2026/2027.

2. Afati i kësaj marrëveshjeje të bashkëpunimit, i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, mund të zgjatet me aneks të kësaj marrëveshjeje, me pajtimin e palëve.

Neni 5

Praktika profesionale në QKUK

1. QKUK merr përsipër të mundësojë kryerjen e praktikës profesionale për nxënësit e SHMLM Austrian Schule, sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje dhe legjislacionit në fuqi.
2. Praktika profesionale sipas paragrafit 1 të këtij neni organizohet në pajtim të plotë me planin e punës së QKUK-së.
3. Praktika klinike në QKUK për nxënësit e SHMLM Austrian Schule organizohet çdo ditë pune, sipas planit dhe programit të hartuar në bashkëpunim nga të dy palët nënshkruese.

Neni 6

Obligimet e QKUK

1. QKUK është e obliguar të ofrojë kushtet dhe hapësirat e nevojshme që mundësojnë kryerjen e praktikës profesionale sipas kësaj marrëveshjeje.
2. QKUK, përmes personit përgjegjës të caktuar, mbikëqyr organizimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e praktikës profesionale për nxënësit e SHMLM Austrian Schule.
3. QKUK, me pëlqimin e nxënësit/es, mund ta angazhojë atë në procesin e punës, kryesisht në funksione ndihmëse, të cilat përkojnë me nivelin e zhvillimit dhe njohurive të nxënësit/es.
4. Nxënësit/et që kryejnë praktikën profesionale sipas kësaj marrëveshjeje nuk kanë të drejtë të ndërmarrin asnjë veprim profesional ndaj pacientëve të QKUK-së pa mbikëqyrjen e ekipit të edukimit të vazhdueshëm profesional infermieror në kuadër të QKUK-së dhe personit përgjegjës të emëruar nga SHMLM Austrian Schule.
5. QKUK mban evidencë dhe lëshon vërtetim për kryerjen e praktikës profesionale për nxënësit që e kanë përfunduar atë në mënyrë të rregullt.

Neni 7

Obligimet e SHMLM Austrian Schule

1. SHMLM Austrian Schule përgatit dhe harton listën e nxënësve që do të kryejnë praktikën profesionale në QKUK dhe mban përgjegjësi për saktësinë e saj.
2. Nëse gjatë realizimit të praktikës profesionale nxënësit e SHMLM Austrian Schule eventualisht shkaktojnë dëme në aparaturë apo dëme të tjera në QKUK, atëherë SHMLM Austrian Schule obligohet të bëjë kompensimin e dëmit, pas paraqitjes së provave dhe procesverbalit nga ana e QKUK-së, sipas evidentimit dhe dokumentimit të dëmit të shkaktuar.
3. SHMLM Austrian Schule ka për obligim të caktojë personin përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e punëve, i/e cili/a, në bashkëpunim me personin përgjegjës të caktuar nga QKUK, do të harmonizojë planin e kryerjes së praktikës profesionale me planin e punës së QKUK-së.
4. SHMLM Austrian Schule njofton paraprakisht QKUK-në për organizimin e vizitave studimore në Austri që lidhen me praktikën profesionale dhe, sipas mundësive dhe natyrës së vizitës, fton një përfaqësues të QKUK-së për të marrë pjesë në këto vizita.

Neni 8

Kushtet e përgjithshme për realizimin
e praktikës Klinike në QKUK

1. SHMLM Austrian Schule duhet të njoftojë të gjithë nxënësit të cilët do të realizojnë praktikën klinike dhe ushtrimet në QKUK për detyrat, përgjegjësitë dhe sjelljen e tyre gjatë realizimit të praktikës.

2. Personi përgjegjës i caktuar nga QKUK dhe personi përgjegjës nga SHMLM Austrian Schule, sipas kësaj marrëveshjeje, harmonizojnë planprogramin dhe realizimin e praktikës profesionale për nxënësit e SHMLM Austrian Schule.

3. Organizimi i praktikës profesionale sipas kësaj marrëveshjeje nuk duhet të pengojë procesin e punës në njësitë organizative të QKUK-së.

4. Nxënësit e SHMLM Austrian Schule, të cilët kryejnë praktikën në QKUK sipas kësaj marrëveshjeje, kanë për obligim që gjatë kryerjes së praktikës të mbajnë uniforma standarde dhe kartelën e identitetit.

5. Personi përgjegjës i caktuar nga QKUK, në bashkëpunim me personin përgjegjës të caktuar nga SHMLM Austrian Schule, caktojnë edhe stafin tjetër, sipas nevojës, për organizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve për nxënësit e SHMLM Austrian Schule, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vijueshmëria e nxënësve të SHMLM Austrian Schule është në kompetencë të SHMLM Austrian Schule, e cila, përmes mekanizmave të saj të brendshëm, përcjell vijueshmërinë e nxënësve dhe mban evidencën përkatëse.

Neni 9

Mbikqyrja e zbatimit të marrëveshjes

Për QKUK-në, mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj marrëveshjeje e bëjnë personi përgjegjës i caktuar nga QKUK dhe drejtori i klinikës përkatëse.

Neni 10

Ndryshimi i marrëveshjes dhe zgjidhja e kontesteve

1. Nëse palët dëshirojnë të ndryshojnë kushtet e kësaj marrëveshjeje, ndryshimet mund të bëhen me pajtimin e të dyja palëve, pas njoftimit paraprak me shkrim prej së paku tri (3) ditësh kalendarike, dhe formalizohen përmes aneksit të kësaj marrëveshjeje.

2. Në rast të ndonjë kontesti ndërmjet palëve lidhur me zbatimin ose interpretimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje, palët do të përpiqen ta zgjidhin atë me mirëkuptim.

Neni 11

Numri i ekzemplarëve

Kjo marrëveshje është e hartuar në katër (4) kopje origjinale, nga dy (2) për secilën nga palët e saj.

Neni 12

Dispozitat shfuqizuese

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje shfuqizojnë çdo marrëveshje të mëparshme të lidhur për të njëjtin qëllim ndërmjet palëve nënshkruese.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dyja palët dhe protokollimin e saj.

PALËT NËNSHKRUESE

Shqiponja Vokshi
Drejtoreshë e SHMLM "Austrian Schule"

Mentor Zejnullahu
Drejtor i Përgjithshëm i QKUK